



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.414/22

Gjykata Komeriale - Dhoma e Shkalles se Dytë ne Prishtinë, me gjyqtaren Saranda Bogaj-Sheremeti, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Dogana e Kosovës”, ndaj debitorit NTP “I...” me seli ne Ferizaj rr. “....” me nr. biznesit .... te cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokateve “SCLR Partners” shpk me seli ne Prishtinë , me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, te parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, E.nr.349/2021, të datës 18.06.2021, me datë 03.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit NTP “I...” me seli ne Ferizaj rr. “ ....” me nr. biznesit .... te cilin e përfaqëson Shoqëria e Avokateve “SCLR Partners” shpk me seli ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm, E.nr.349/2021, të datës 18.06.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar, E.nr.349/2021, të datës 18.06.2021, e ka pranuar pjesërisht prapësimin e debitorit NTP “I...” me seli ne Ferizaj rr. “....” me nr. biznesit ...., i ushtruar kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimor E.nr.1525/12 dt.27.02.2014, sa i përket shumës se gjobës prej 5500 euro dhe shfuqizon aktvendimin mbi lejimin e përmbartimor E.nr.1525/12 dt.27.02.2014 të dhënë nga Gjykata Themelore ne Ferizaj për shumen e borxhit prej 5. 500 euro. Po ashtu refuzon prapësimin e debitorit NTP “I...” me seli ne Ferizaj rr. “....” me nr. biznesit ...., i ushtruar kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimor E.nr.1525/12 dt.27.02.2014 sa i përket shumes se gjobës prej 4500 euro dhe mbetet ne fuqi aktvendimi për lejimin e përmbartimit E.nr.1525/12 dt.27.02.2014 për shumen e gjobës prej 4500 euro dhe shpenzimet tjera te përmbartimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbartimore, me propozim qe Gjykata e shkalles se dytë, ta aprovoj këtë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe ta obligoj kreditorin qe debitorit t’ia kompensoj shpenzimet procedurale.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit përmbartues-Aktvendimit të Doganës së Kosovës –Komisioni për Kundërvajtje Doganore nr. .... të datës 14.09.2011, i cili ka qenë i ekzekutueshëm nga data 23.08.2012 dhe i formës së prere nga data 24.09.2012.

Gjykata Themelore në Ferizaj, duke vepruar sipas propozimit për përmbartimin e kreditorit, me aktvendimin përmbartimor E.nr.1525/12 të datës 27.02.2014, e ka caktuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor.

Debitori me datë 06.03.2014, ka parashtruar prapësim, me arsyetimin se gjykata gabimisht ka konstatuar se aktvendimi është i plotfuqishëm duke u bazuar vetëm në vullat e Doganës së Kosovës në vendimet e veta ngase si ka mundësi që një vendim të jetë i plotfuqishëm nëse ndaj tij është ushtruar ankesë në një instancë më të lartë ashtu si në këshillën juridike të vendimit të Doganës. Debitori ka paraqitur ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime brenda afatit ligjor, andaj vendimi i Doganës nuk është titull ekzekutiv, ashtu që propozon të aprovohet si i bazuar prapësimi, të anulohet vendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe të obligohet kreditori të kompensojë debitorin shpenzimet procedurale.

Gjykata Themelore në Ferizaj, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin E.nr.349/2021, të datës 18.06.2021, me të cilin e ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar prapësimin e debitorit duke vendosur si në dispozitiv të njëjtë. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se konform udhëzimeve të Gjykatës së Apelit në aktvendimin Ac.nr.3084/20 dt.25.02.2021, ka mbajtur seancën dëgjimore me datën 24.05.2021 në të cilën i autorizuar i kreditorit ka shtuar se në fillim kishte propozuar përmbartimin e shumës prej 10 000 euro e cila shumë me vendimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime ka zbritur në shumën prej 4500 euro me çka kreditori precizon shumën prej 4500 euro për pagesën e gjobës dhe shpenzimet e përmbartimit. Me këtë rast Gjykata ka detyruar kreditorin konform nenit 17, 38 par.1 dhe 2 të LPP dhe nenit 102 të LPK që ta bëjë plotësimin e propozimit për përmbartim të dorëzuar me datë 01.10.2012 brenda afatit prej 7 ditësh nga mbajtja e seancës dëgjimore. Me datën 02.06.2021 kreditori në gjykatë ka dorëzuar parashtrësën me shkrim të datës 25.05.2021 për plotësimin e propozimit për përmbartim ashtu që ka kërkuar që gjykata të vazhdojë procedurën e përmbartimit

dhe ta detyroj debitorin që ta paguaj në emër të gjobës shumen prej 4,500 euro si dhe shpenzimet tjera përbarimore. Gjykata pretendimin e debitorit se vendimi i Doganës nuk ka titull ekzekutiv dhe se nuk është i plotfuqishëm e konsideron si të pabazuar pasi në kohën kur gjykata ka lejuar përbarimin ka vepruar konform nenit 22 par.1 në par.2 të LPP sepse aktvendimi mbi shqiptimin e gjobës ka qenë i formës së prerë. Gjykata vlerëson vendimin e Bordit të Pavarur për Rishqyrtime A.nr.409/2011-DK dt.06.05.2014 i cili me këtë aktvendim ka ndryshuar vendimin e Doganës së Kosovës duke e zbritur gjobën administrative prej 10,000 euro në shumen 4,500 euro. Andaj në rastin konkret vlerësoi se nuk është e nevojshme të nxjerr serish aktvendim mbi lejimin përbarimit për shumen e mbetur të borxhit ngase kemi të bëjmë me ulje të kërkesës së kreditorit por jo edhe rritje të kërkesës. Andaj duke marrë parasysh provat në lëndë, prapësimin debitorit, konstatoi se prapësimi i debitorit për shumen prej 5500 euro është i bazuar pjesërisht dhe shfuqizoj aktvendimin mbi lejimin e përbarimit, kurse nuk është i bazuar prapësimi i debitorit për shumen e gjobës prej 4 500 euro dhe për shpenzimet e përbarimit, për të cilën shume të gjobës dhe për shpenzimet e përbarimit gjykata vendosi që të mbetet në fuqi aktvendimi mbi lejimin e përbarimit.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës e Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e shkallës e dytë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës e dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se aktvendimi i Doganës së Kosovës-Komisioni për Kundërvajtje Doganore 04.2.3.1/643 dt.14.09.2011, është përbarimor dhe i plotëson kushtet nga neni 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokument përbarues është edhe vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (me tej: ujdia)”* dhe përbënë bazën juridike për caktimin e përbarimit sipas nenit 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 24 paragraf 3 dhe neni 27 paragraf 1, të po këtij ligji ku përcaktohet se: *“Dokumenti përbarimor është i përshtatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”*, ndërsa një dokument përbarimor për të shërbyer si titull përbarues patjetër duhet të përmbaj elementet e përcaktuara me nenin 27 paragrafi 1, të cilat e bëjnë si dokument të përshtatshëm përbarimor. Kjo gjykatë pranon përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe refuzon pretendimin e debitorit se aktvendimi i Doganës së Kosovës nuk i plotëson kushtet si titull ekzekutiv nga fakti se kemi ushtruar ankesë në Bordin e Pavarur për Rishqyrtime, sepse gjykata bazuar nga shkresat në lëndë dhe aktvendimi i lëshuar nga Bordi i

Pavarur për Rishqyrtime A.nr.409/2011 –DK dt.06.05.2014, ka konstatuar me te drejtë se ankesa e ushtruar nga debitori kundër vendimit nr.05.2.1/980 është aprovuar pjesërisht si e bazuar dhe është ndryshuar aktvendimi i Doganës se Kosovës 05.2.1/980 dt.31.10.2011 ashtu që gjoba administrative është zbritur nga 10 000 euro në 4 500 euro. Po ashtu vlerëson se bazuar në shkresat e lëndës konstatohet se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar konform vërejtjeve të Gjykatës së Apelit në aktvendimin Ac.nr.3084/20 dt.25.02.2021 ashtu që ka caktuar seancën dëgjimore me datën 24.05.2021 në të cilën kreditori ka bërë precizimin e kërkesës së tij pas ndryshimit të vendimit nga Bordi i Pavarur për Rishqyrtime ashtu që lartësia e gjobës administrative tash e tutje mbetet në shumën prej 4500 euro si dhe shpenzimet tjera, ndërsa kreditori konform kërkesës së gjykatës, me datën 25.05.2021 ka paraqitur në Gjykatën Themelore në Ferizaj parashtresën me shkrim për Plotësimin e Propozimit për Përmbarrim me kërkesën prej 4 500 euro të gjobës administrative. Nga e gjithë kjo rezultoi se aktvendimi i ankimuar i shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm sepse nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet për anulimin apo shfuqizimin e urdhrit për përmbarrim nga neni 71 të LPP.

Dhoma e shkallës së Dytë mori parasysh edhe pretendimet ankimore të debitorit lidhur me faktin se gjykata në shkallë të parë ka bërë shkelje nga neni 36.1 të LPP-së, mirëpo kjo gjykatë vlerëson se një pretendim i tillë është i pabazuar sepse vërtetimi i përmbarrueshmërisë nga pala kreditore është bërë me dokument përmbarrues, origjinal e cila ka përmbajtur klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri.

Në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarrimin

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha me lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NE PRISHTINË  
DHOMA E SHKALLES SE DYTË  
K.DH.SH.II nr.414/22, me datë 03.11.2022

Gjyqtarja  
Saranda Bogaj-Sheremeti